



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 23/1 Prot

Tiranë, më 28.02.2023

V E N D I M

Nr.19, datë 28.02.2023

Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Ministrinë e Brendshme dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë.

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar; në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjen e zhvilluar në Ministrinë e Brendshme,

VËREJ SE:

Me vendimin nr. 107, datë 15.07.2022 “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë procesit të vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë në aparatit të Ministrisë së Brendshme”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e procesit të mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë kryerjes së procedurës së vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë në aparatit të Ministrisë së Brendshme.

Objekti i mbikëqyrjes përfshin kontrollin dhe vlerësimin e veprimeve administrative të kryera nga zyrtarët e ngarkuar me detyra specifike në vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë të aparatit të ministrisë, për vlerësimet e fundit që përkojnë me periudhën korrik - dhjetor 2021 dhe janar - qershor 2022.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes nr. 571/1 prot., datë 15.07.2022, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili i është njoftuar subjektit me shkresën nr. 571/2 prot., datë 15.07.2022 “Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në Ministrinë e Brendshme”.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projektraportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë gjatë realizimit të procedurave të vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë dhe ia ka dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 571/3 prot., datë 14.12.2022, duke i lënë 15 ditë kohë për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes.

Pas kësaj, me shkresën nr. 7546/3 prot., datë 05.01.2023 (*protokolluar në KMSHC me nr. 23, dt.06.01.2023*), institucioni i mbikëqyrur ka dërguar projektraportin e nënshkruar nga personat përgjegjës, pa vërejtje, duke u shprehur dakord me gjetjet e grupit të punës të pasqyruara në të.

Nga ana tjetër, njësia përgjegjëse DAP, me shkresën nr. 6481/1 prot., datë 3.2.2023 "*Mbi projektraportet përfundimtare të mbikëqyrjes në shërbimin civil*", informon Komisionerin se, në respektim të parashikimeve ligjore, ka nisur procesin e vlerësimit të nëpunësve civilë anëtarë të TND-së. Procedura e vlerësimit për këtë kategori nëpunësish është përmbyllur nga Komisioni Kombëtar i Përzgjedhjes në disa ministri por Ministria e Bredshme nuk është e përfshirë në përmbajtjen e shkresës së DAP, pasi ky proces nuk është kryer nga institucioni.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar, referuar Seksionit III "*Procedura hetimore*", të ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*", si dhe Rregullores "*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë procesit të vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë në aparatit e Ministrisë së Brendshme, i cili është pjesë e këtij vendimi dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë.

2. Nisur nga fakti që procesi i vlerësimit të nëpunësve civilë, anëtarë të TND-së nuk është kryer, njësia e burimeve njerëzore të aparatit të Ministrisë së Brendshme, duhet të drejtojë procesin e vlerësimit të të gjithë nëpunësve civilë të këtij grupi, të emëruar në pozicionet “*Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme*”, sipas formularit të vlerësimit të përcaktuar në kreun IV, të VKM nr. 109, datë 26.2.2014, i ndryshuar. Më tej, formularët e vlerësimit duhet tja dërgojë zyrtarisht njësisë përgjegjëse (DAP).

3. Njësia përgjegjëse (DAP), të drejtojë procesin në mënyrë që Komisioni Kombëtar i Përzgjedhjes (KKP), bazuar në përcaktimet e pikës 3, të nenit 62, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe në respektim të procedurave të parashikuara në vendimin nr. 109, datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*”, i ndryshuar të përmbyllë saktë procedurën e vlerësimit të rezultateve në punë për 6 mujorin e parë të vitit 2023.
 - ✓ Formulari i vlerësimit i plotësuar dhe nënshkruar nga KKP-ja, t’i përcillet zyrtarisht anëtarit të TND-së, me qëllim që nëpunësi të nënshkruajë duke deklaruar marrjen dijeni, si dhe dakordësinë apo mosdakordësinë e tij lidhur me vlerësimin e kryer.

 - ✓ Më tej njësia e burimeve njerëzore e institucionit, të përfshijë në Regjistrin Qendror të Personelit formularin e vlerësimit për çdo nëpunës civil siç përcaktohet në pikën 18, kreu II, të vendimit nr. 109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*”, i ndryshuar.

 - ✓ Formulari i vlerësimit të çdo nëpunësi civil të administrohet në dosjen e personelit si një e dhënë e përgjithshme që lidhet me marrëdhënien e punës, siç parashikohet në pikën 1, kreu II, të vendimit nr. 833, datë 28.10.2020, të Këshillit të Ministrave “*Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit*”.

4. Në rastet kur shihet e nevojshme shtyrja e afatit të periudhës së provës për nëpunësit civilë të nivelit ekzekutiv, në zbatim të detyrimeve të parashikuara nga shkronja b), pika 7, kreu VI, i VKM nr. 243, datë 18.3.2018 “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, i ndryshuar, eprori direkt duhet të nxjerrë një vendim të arsyetuar për shtyrjen e afatit të konfirmimit.

5. Në rastet kur nëpunësit e kategorisë së mesme apo të lartë drejtuese, të cilët për shkak të pozicionit të tyre të punës janë zyrtarë vlerësimi, largohen nga detyra, ata duhet të bëjnë vlerësime të pjesshme të nëpunësve për të cilët ata paraqiten si “*Zyrtar raportues*”, duke bërë shënime të përkatëse në ndarjen A të formularit, në rubrikën “*Periudha e vlerësimit*”.

- ✓ Zyrтари autorizues në rastet kur kryen detyrën e vlerësimit si zëvendësues i zyrtarëve të tjerë të vlerësimit, të materializojë kryerjen e detyrës edhe si zëvendësues duke plotësuar e nënshkruar në hapësirën/nënndarjen përkatëse të ndarjes D “Nënshkrimi” duke bërë vlerësim të përmbledhur për gjithë periudhën 6 mujore të vlerësimit.
6. Në rastin e vlerësimeve të pjesshme për shkak të largimit të zyrtarëve që duhet të bëjnë vlerësimin, zyrtari raportues zëvendësues që përmbyll procesin e vlerësimit duhet të bëjë vlerësim përfundimtar për gjithë periudhën 6 mujore të vlerësimit.
 7. Të tregohet kujdes maksimal për individualizimin e secilit vlerësim, sipas punës së kryer dhe cilësive personale të nëpunësve. Gjatë kryerjes së kësaj procedure, nëpunësit e ngarkuar me kompetencën e vlerësimit të rezultateve në punë (*zyrtari raportues*), në zbatim të përcaktimeve të aktit nënligjor, për vlerësimin e arritjeve në punë, duhet të plotësojnë hapësirat “*Komentet e zyrtarit raportues/Shpjegime*” duke vlerësuar punën e bërë për arritjen e çdo objekti të caktuar.
 8. Zyrtarët raportues të identifikojnë kërkesat e nëpunësve të vlerësuar për trajnim dhe mundësi zhvillimi të veçantë profesional, të hartojnë rekomandimet përkatëse për trajnimin e tyre dhe më tej t’i paraqesin për miratim pranë Zyrtarit autorizues
 9. Zyrtarët kundërfirmues si mbikëqyrës të drejtpërdrejtë të zyrtarëve raportues, të sigurojnë një vlerësim objektiv të nëpunësve si dhe ky vlerësim të pasqyrojë kriteret e politikës së përgjithshme, si dhe të mbajnë kontakte të rregullta me zyrtarët raportues, të identifikojnë nevojat e tyre për trajnim duke i adresuar ato pranë Zyrtarit autorizues për të siguruar një ecuri normale të sistemit të vlerësimit.
 10. Zyrtari autorizues si përgjegjësi kryesor i sistemit të vlerësimit, të sigurojë që të gjithë zyrtarët raportues dhe kundërfirmues të kenë njohuri të plota për realizimin e procedurës së vlerësimit. Të vlerësohen nevojat për trajnimin e zyrtarëve raportues dhe zyrtarëve kundërfirmues me qëllim që procedura e vlerësimit të realizohet në përputhje me standartet e kërkuara nga vendimi nr. 109, datë 26.2.2014, i Këshillit të Ministrave.
 11. Të hartohet një plan trajnimi me karakter të posaçëm për kryerjen e detyrave të veçanta që ju vendos zyrtarëve të vlerësimit legjislativi i shërbimit civil. Ky plan t’i njoftohet zyrtarisht njësisë përgjegjëse DAP dhe Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), të cilët bazuar në çështjet konkrete të adresuara të bëjnë të mundur ndjekjen e trajnimeve të veçanta.
 12. Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore t’i njoftojë të gjithë aktorët e procesit të vlerësimit të rezultateve në punë me vendimin e Komisionerit, pasi në përfundim të afatit të paralajmërimit, përgjegjësia do të jetë personale për nëpunësin që nuk ka zbatuar detyrat e përcaktuara në vendim.

Zyrtarët e ngarkuar me procesin e vlerësimit, mund të njihen me përmbajtjen e këtij vendimi dhe Raportin përfundimtar të mbikëqyrjes edhe nëpërmjet faqes zyrtare të Komisionerit, në adresën www.kmshc.al.

- 13.** Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat *5 muaj* nga marrja dijani për këtë vendim, me qëllim që zyrtarët e ngarkuar me procesin e vlerësimit, Zyrtari raportues, Zyrtari kundërfirmues, Zyrtari autorizues, Departamenti i Administratës Publike në cilësinë e njësisë përgjegjëse, Komisioni Kombëtar i Përzgjedhjes dhe njësia e burimeve njerëzore e institucionit, të zbatojnë detyrat e lëna në këtë vendim dhe në Raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, gjatë kryerjes së procedurës së vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë që do të realizohet për 6 mujorin e parë të vitit 2023.
- 14.** Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, Ministria e Brendshme, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi dhe të dërgojë dokumentacionin që vërteton masat e marra për të rregulluar situatën e ligjshmërisë.
- 15.** Për këtë vendim të njoftohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Brendshme dhe Departamenti i Administratës Publike (DAP), duke i dërguar një kopje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.
- 16.** Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
- 17.** Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha